

VENDIM
Nr. 184, datë 25.3.2021

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE “BLUE
1”, I CILI NUK PËRFITON NGA MASAT MBËSHTETËSE, NË ZONËN SHEQ-
MARINAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I
SHOQËRIVE “BLESSED INVESTMENT” SHPK DHE “MATRIX
KONSTRUKSION” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse “Blue 1”, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS:

“Blessed Investment” sh.p.k. - L71423028S;

“Matrix Konstruksion” sh.p.k. – J91306009Q;

c) Tipi i centralit: fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 50 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë: koha për ndërtimin e vënien në operim të parkut fotovoltaik të jetë brenda 50 (pesëdhjetë) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: centrali fotovoltaik “Blue 1”, zona Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier;

e) Afati i miratimit të ndërtimit: 60 (gjashtëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

ë) Koordinatat e tokës sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuar prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Transferimi i së drejtës për ndërtim të burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një person i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., ka detyrimin:

i. që të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucioneve të tjera të autorizuar prej saj informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. që të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprahe mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. e dorëzimit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë

përcaktohen të drejtat e detyrimit e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “*Blessed Investment*” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k. do të krijojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin e administrimin e centralit fotovoltaiik “*Blue 1*”. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “*Blessed Investment*” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., dhe shoqëria për qëllime të veçanta do të jenë bashkërisht përgjegjëse për detyrimet sipas këtij miratimi dhe kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

iv. që t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, bashkimi i përkohshëm i shoqërive “*Blessed Investment*” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k. duhet t’i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 1

Sipërfaqja e tokës: rreth 610,400 m² - 61 ha.

Koordinatat e tokës

X_UTM	Y_UTM	X_GAUSS	Y_GAUSS	X_KRRGJSH	Y_KRRGJSH
364972.37	4514197.96	4365048.75	4516135.12	449351.13	4514946.14
364721.23	4514219.6	4364797.51	4516156.78	449099.72	4514964.92
364659.7	4514030.38	4364735.95	4515967.47	449040.33	4514774.97
364500.68	4513900.12	4364576.87	4515837.17	448882.78	4514642.88
364449.88	4513610.26	4364526.05	4515547.19	448835.27	4514352.4
364479.49	4513671.27	4364555.67	4515608.22	448864.19	4514413.75
364648.98	4513454.27	4364725.23	4515391.14	449036.18	4514198.66
364629.43	4513416.47	4364705.68	4515353.32	449017.06	4514160.63
364968.05	4513383.17	4365044.43	4515320	449356.1	4514131.18
365148.76	4513466.62	4365225.21	4515403.49	449535.88	4514216.71
365278.83	4513418.4	4365355.34	4515355.25	449666.53	4514169.97
365017.21	4512828.06	4365093.61	4514764.66	449411.6	4513576.55
364812.92	4512846.4	4364889.24	4514783.02	449207.07	4513592.57
364692.28	4512776.93	4364768.55	4514713.51	449087.21	4513521.71
363441.06	4512791.1	4363516.81	4514727.7	447835.64	4513521.63
364337.48	4514501.16	4364413.6	4516438.45	448712.69	4515242.14
364445.68	4514513.9	4364521.85	4516451.2	448820.77	4515256.12
365030.78	4514264.82	4365107.18	4516202.02	449408.79	4515013.68

Shtrirja gjeografike e vendit ku do të zhvillohet impianti fotovoltaiik “Blue 1”:

